



01-06-2017



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretarati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Prishtinë / Pristina
Nr./Br. 849 - 2017

Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 83.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 4 të Rregullës Zgjedhore Nr.16/2013, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 01.06.2017, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Ndryshimin e Qendrave të Votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2017

- I. Miratohet ndryshimi i qendrave të votimit, për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, 2017.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është arsyeshmëria e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, për ndryshimin e qendrave të votimit dhe tabela e qendrave të ndryshuara, për komunat përkatëse.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 01.06. 2017

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve


Valdete Daka




Arsyeshmëritë për ndryshimin e Qendrave të Votimit – 2017

1. Komuna Leposaviq:

QV - 1201x, lokacionin e kësaj qendre mendojmë ta ndryshojmë për shkak se në lokacionin e vjetër nuk ka kushte adekuate për mbajtjen e procesit të votimit. Në Zgjedhjet Parlamentare 2014 QV ishte në Shtëpinë e Kulturës, ndërsa tani propozojmë që kjo Qendër Votimi, pra QV-1201x, të zhvendoset 50 metra përballë Shtëpisë së Kulturës, e që tani është Shkolla Fillore “Nikolla Tesla”.

2. Komuna Rahovec:

- QV-1602x, për shkak të demolimit të objektit të shkollës fillore "7 Shtatori" objekti nuk i plotëson kushtet elementare për mbajtjen të procesit zgjedhor, ne si KKZ kërkojmë që procesi zgjedhor të zhvillohet në Shkollën e Mesme e Lartë Profesionale "Selajdin Mullabazi-MICI", 500 metra larg ish shkollës "7 Shtatori". Për këtë janë të njoftuar të gjithë akteret që janë pjesëmarrës në zgjedhje duke përfshirë edhe votuesit. KKZ – Rahovec, mendojmë që votuesve t'i ofrojmë ambiente më të përshtatshme për votim.
- Me propozimin e KKZ-s, dhe aprovimin e tyre unanim, kemi ardhur në përfundim se qendra 1633a, nuk i plotëson kushtet as minimale si Qendër e Votimit me e madhja në komune. Ku në këtë qendër gjithsej janë 6172 votues, dhe hapësira e kësaj qendre është shumë e vogël dhe e pa përshtatshme për zhvillimin normal të këtij procesi. Pas njoftimit nga koordinatori ne kemi marrë veprime për njoftimin e qytetarëve, duke postuar në portale dhe në faqet e subjekteve politike. Prandaj informata lidhur me këtë është plasuar tanimë edhe tek votuesit për ndryshimin në këtë qendër. Me propozimin e të gjithë anëtarëve të KKZ-së kërkojmë bartjen e këtyre votuesve.

Ndërsa, votuesit e Qendrës së Votimit 1626a Shkolla “Isa Boletini” të barten në QV 1633a shkolla fillore “Ardhmëria” që janë gjithsej 178 votues. Pra kemi të bëjmë me ndërrim të këtu dy lokacioneve.

3. Komuna Pejë:

- KKZ – Pejë, informon se në Zgjedhjet Parlamentare 2014, për shkak të renovimit të Shkollës Fillore “8 Marsi” - QV-1704x e kemi shfrytëzuar Fakultetin “Haxhi Zeka”. Tani kjo qendër prapë do të kthehet në Shkollën Fillore “8 Marsi” për shkak kjo shkollë është ri funksionalizuar dhe aty ka qenë çdo herë Qendra e Votimit.
- QV 1704c Shkolla Fillore “Ramiz Sadiku”, në vitin 2014 ishte në renovim dhe si qendër kemi shfrytëzuar Shkollën e Mesme “Shaban Spahija”. Këto dy shkolla

gjenden në të njëjtin oborr, prandaj si Qendër Votimi – 1704c do të përdorim shkollën Mesme Teknike “Shaban Spahija”.

Sqarim: QV – 1704y – Shkolla e Mesme Teknike “Birova” mbetet prapë si Qendër e votimit për zgjedhjet Parlamentare 2017.

Për këto lëvizje janë të njoftuar votuesit, Menaxherët e shkollave në të cilat QV i kemi dërguar edhe Listat Preliminare të Votuesve, dhe për këtë lëvizje nuk do të ketë ndonjë pengese.

4. Komuna Shtime:

- QV – 2210e – Shkolla e mëparshme “Bajram Curri” me lokacion në Topillë, e cila ka shërbyer si Qendër e Votimit në Zgjedhjet Parlamentare 2014 tanimë nuk plotëson as kushtet elementare për mbajtjen e procesit të votimit. Për këtë arsye KKZ - Shtime kërkon të bëjë zhvendosjen e kësaj qendre QV-2210e në shkollën “Emin Duraku” në Shtime.

5. Komuna Ferizaj:

- QV – 2503d – Për shkak të renovimit të ish Shkollës Ekonomike “Faik Konica”, lokacioni i QV-së 2503d të zhvendoset 250 metra larg nga shkolla “Faik Konica” për në lokacionin e ri në Gjimnazin Shkencor “Kuvendi i Arbërit”. Te gjitha masat e nevojshme i kemi ndërmarrë ne si KKZ për këtë ndryshim të këtij lokacioni.

6. Komuna Vushtrri:

- QV – 2702b – Qendra/lokacioni në fjalë, me saktësisht Shkolla “Ali Kelmendi” është përdorur gjithmonë më parë si Qendër Votimi; për arsye se ka qenë në renovim në vitin 2014 ka qenë jo-funksionale. Tashmë, kjo qendër është kthyer në lokacionin e vjetër/paraprak – Shkollën “Ali Kelmendi”.
- QV – 2704b – Qendra/lokacioni në fjalë, me saktësisht Shkolla “Mustafë Venhari” është përdorur më parë si Qendër Votimi; për arsye se ka qenë në renovim ka qenë jo-funksionale. Tashmë, kjo qendër është kthyer në lokacionin e vjetër/paraprak – Shkollën “Mustafë Venhari”.

7. Komuna Zubin Potok:

QV – 2815b – Në lokacionin në fjalë, më saktësisht në Ugljar ku ka qenë QV në objekt privat tashmë kemi menduar që Shkolla Fillore “Jovan Cvijic” të jetë QV për këto votimin në Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare 2017, pra kemi menduar që edhe për QV 2816b Jasenoviku i Poshtëm të kemi në të njëjtin objekt sepse ka kushte të përshtatshme për votim. Kemi bërë edhe njoftimet e neper këto QV edhe listën preliminare të votuesve e kemi shpërndarë neper këto lokacionet e reja të propozuara nga KKZ Zubin Potok. Pra, QV 2815b dhe 2816b të jenë në një objekt me hyrje të ndara nga njëra tjetra. Ne si KKZ kemi bërë edhe njoftimet për votuesit për ndryshimet e këtyre dy lokacioneve.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Prishtina, rr./ul. Mirgjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariat@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

№/ Komunes Qendrore	Komuna/Qendras	Qendra e Votimit 2017	Objekt/Vendi / Grahshketo	Lokacioni Detaj	Drejtim Lokadje	Komente
2	Leposavic/Leposavice	12013x	Leposavic/Leposavice	Shkolla Fillore "Nikola Tesla"	Sretnja Skola "Nikola Tesla"	Vendikacioni ka ndryshuar sepse ne lokacione e vjeter nuk ka pasur kushte adekuate
3	Rahovec/Drahovac	1602k	Rahovec/Drahovac	S-ULP Selajdir Vulliaabazi	Selajdir Vulliaabazi	Ish Shkolla "7 Shtatori" - 500 metra distanca mes tyre
21	Rahovec/Drahovac	1602Ba	Rahovec/Drahovac	Shkolla Fillore "Arçmeria"	Osnovna škola "Arçmeria"	Ish Shkolla Fillore "Sa Boletini" ndrim me Lokacioni me 1633a
28	Rahovec/Drahovac	1633a	Rahovec/Drahovac	Shkolla Fillore "Sa Boletini"	Osnovna škola "Sa Boletini"	Shkolla Fillore "Arçmeria" ndrim me Lokacioni me 1626a
4	Peje/Peć	1704c	Peje/Peć	Shkolla e Vespre Teknikke "Shaban Spahija"	Sretnja Tehnicka Shkolla "Shaban Spahija"	Ridrejtuar ne Objektiv ku ka qene ne zgjedhjet e mepershtime, sepse ky objekt ne vitin 2014 ka qene ne rinovim.
5	Peje/Peć	1704k	Peje/Peć	Shkolla Fillore "8 Varsa"	Osnovna škola "8 Vart"	Ridrejtuar ne Objektiv ku ka qene ne zgjedhjet e mepershtime, sepse ky objekt ne vitin 2014 ka qene ne rinovim.
6	Peje/Peć	1704y	Peje/Peć	Shkolla (Ish Biron Shkolla)	Shkolla (Ish Biron Shkolla)	Permitesim Emri
11	Shtime/Stimlje	2210a	Topille/Topilla	Shkolla Fillore "Emir Duraku"	Osnovna škola "Emir Duraku"	Shkolla e mepershtime nuk ka poretuar as kushtet elementare per mbajtjen e procesit te votimit, per kete arsye qendra 2210e zhvendoset ne shkollën Emir Duraku.
6	Feriza/Urševac	2509d	Feriza/Urševac	Gimnazi "Stencor" Kuvenci i Arberit	Sretnja Shkolla (Ish Gjimnazia) "Kuvenci i Arberit"	Per shtak te renovimit te shkolles, vendikacioni i QV-se 2503d zhvendoset 200 m me larg nga lokacioni i mepershtim (Ish Shkolla Ekonomike).
2	Vushtrri/Vučitrn	2702a	Vushtrri/Vučitrn	Shkolla Ali Kelmenci	Shkolla Ali Kelmenci	Qendrat e shkolles perdorur me pare si QV, per arsye se ka qene ne renovim ka qene jo funksionale. Tash QV eshte kthyer ne lokacionin e vjeter.
5	Vushtrri/Vučitrn	2702b	Vushtrri/Vučitrn (S-1)	Shkolla "Vustate Venhari"	Shkolla "Vustate Venhari"	Qendrat e shkolles perdorur me pare si QV, per arsye se ka qene ne renovim ka qene jo funksionale. Tash QV eshte kthyer ne lokacionin e vjeter.
11	Zubin Potok/Zubin Potok	2814b	Ugljar/Ugljare	Shkolla Fillore "Jovan Cvijic"	Osnovna škola "Jovan Cvijic"	Ne Ugljar nuk ka objekte private per tu leshuar me pages ose objekte shkollore, prandaj lokacioni eshte vendosur ne Zubin Potok 3km larg nga Ugljara
28	Zubin Potok/Zubin Potok	2814b	Dorj Jaserovik/Jaseroviku i poshtem	Shkolla Fillore "Jovan Cvijic"	Osnovna škola "Jovan Cvijic"	Ne Ugljar nuk ka objekte private per tu leshuar me pages ose objekte shkollore, prandaj lokacioni eshte vendosur ne Zubin Potok